Grafikon 19: Distanca totale kundrejt gjithë grupeve etnike.....	51
Grafiku 20: Distanca totale nga ana e të gjithë anëtarëve të grupeve etnike	51
Grafiku 21: Distanca totale ndëretnike nga ana e të gjithë anëtarëve të grupeve etnike-Trend	52
Grafiku 22: Distanca totale etnike - trend	52
Grafiku 23: Distanca totale - Trend	53

RISHIKIMI I ETABELAVE

Tabela 1: Te drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare plotësisht dhe kryesisht (%) - nga ana e anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike.....	37
Tabela 2: Besimi në institucione- Krahasimi ndërmjet anëtarëve të grupeve kryesore etnike	40
Tabela 3: Vlerësimi i Këshillit të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare nga entiteti (%) -- % i madh dhe domethënës kontributi.....	44
Tabela 4: Distanca nderetnike sipas ajteve/marëdhënieve	46

HYRJJE

Shoqëria multi-etnike është e ndjeshme, veçanërisht nga çështjet dhe marrëdhëniet etnike. Kur bëhet fjalë për Malin e Zi, shkalla e ndjeshmërisë është shumë domethënëse, duke pasur parasysh faktin që Mali i Zi është një shoqëri shumë e shquar multi-etnike. Gjithashtu, Mali i Zi i krahasuar si shtet i vogël, identitetin e tij ai e ndan me shtetet e tjera të Rajonit të Ballkanit-hapsira ku në cilën çështjet dhe marrëdhëniet etnike në menyrë tradicionale ndikojnë në komplet jetën shoqërore dhe atë politike. Marrëdhëniet etnike në çdo shtet të Ballkanit, veçanërisht në Mal të Zi, në përmasa të mëdha janë të shqetësuar jo vetëm për marrëdhëniet ndërmjet grupeve të përbashkëta etnike, edhe për marrëdhëniet ndëretnike në gjithë rajonin. Kjo vlen, gjithsesi, kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndërmjet shteteve në rajon, duke patur parasysh që në secilen prej këtyre shteteve një prej grupeve etnike është dominante dhe më e madhe në shtetin përkatës. Ngjarjet e viteve 90-të dhe reminishenca e këtyre ngjarjeve me qëllim ngritjen krijimin e shteteve të pavaruara, shkatërrimin e Jugosllavisë, e shoqëruar me luftë, krizën ekonomike, tranzicion, e më vonë me krizën e madhe botërore, potencialisht janë faktorët të cilët çojnë drejt etnicitetit, dhe referuar kësaj çojnë në joqëndrueshmërinë e grupeve të tjera për një kohë të gjatë. Gjithë këto procese imponojnë nevojë të jashtëzakonshme që marrëdhëniet ndërmjet grupeve etnike të analizohen sistematikisht dhe të ndiqen trendet të cilët tregojnë përmirësimin ose përkeqësimin e këtyre marrëdhënieve.

Ky është ekzaktësisht misioni dhe detyra të cilën CEDEM vendosi e zhvilloi menjëher pas shpalljes së pavarësisë së vendit. Ekzaktësisht, kërkimin e parë për distancat etnike CEDEM e realizoi në vitin 2007-të, pastaj në menyrë periodike ka publikuar kërkimet rreth distancës etnike me qëllimin e ndjekjes së trendeve. Përveç se kërkimit periodik për të cilat perdoren metodat e ndryshme shkencore për matjen e distancave etnike, vet shoqëria dhe gjëndja reale në politikë imponoi disa pyetje të reja, të cilat ishin objekt hulumtimi. Praktika politike në Malin e Zi është e mirëformuar nga marrëdhëniet etnike dhe për këtë arsye lindin strategjitë të cilat janë veçanërisht dedikuar pozicionit të minoriteteve dhe pakicave të tjera kombëtare. Përveç kësaj, vendimet politike krijuan forma të ndryshme etnike institucionale, veçanërisht për minoritetet. Kështu që, çdo minoritet dhe pakicat e tjera kombëtare kanë këshilltarët e tyre ose Këshillin i cili është i integruar në gjithë sistemin politik. Si rrjedhojë, CEDEM ka ndjekur vlerësimin e punës së këtyre Këshilleve nga shtetasit.

Kur bëhet fjalë për minoritetet dhe bashkësitë e tjera minoritare, pyetja kyçe është se në çfarë niveli ndodhet pavarësia në Malin e Zi. Në principet demokratike


mundësohet për minoritetet dhe bashkësitë e tjera minoritare të krijojnë të drejtat e tyre. Për këtë në kërkimet e periudhës së me parshme identifikua të drejtat kryesore të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare dhe matëm se në çfarë niveli respektohen praktikisht në gjithë shoqërinë.

Domethënë më poshtë do paraqesim rezultatet e fundit të cilat i përkasin marrëdhënieve etnike, të drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare, si dhe përqindjet si rezultat i punës së personelit që meren me të drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare. Në situata të mundëshme, rezultatet e hulumtimit do ti shfaqim edhe në formën e trendeve në menyre për të parë ndryshimet që kanë ndodhur me kalimin e kohës.

Rreth Hulumtimit


Hulumtimi u realizua në muajin Maj, viti 2019. Tre qëllimet themelore në të cilat u bazua janë: e para, të vlerësohet shkalla e respektimit të të drejtave themelore të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare; e dyta, të vlerësohet puna efektive e Këshillit të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare; e treta, të matet distanca etnikeKompleksiteti i qëllimeve imponon strategji specifike për marrjen e mostrave. Domethënë, më parë krijuam dhe relizua kampionin përfaqësues për gjithë popullatën e Malit të Zi, pas kësaj si rezultat i kësaj morëm në konsideratë anëtarët e grupeve të veçanta etnike(Shqiptarët dhe Romët). Mostra përfaqësuese ishte e nevojshme për të arritur dy qëllimet e përmendura më sipër, ndërkohë që është dhënë numri i të anketuarëve Shqiptarë dhe Romë i cili ishte i nevojshëm për të patur përqindjen e saktë për vlerësimin e distancës etnike. Në total në hulumtim u përfshin 909 anketues nga 17 bashki në Mal të Zi. Poststratifikimi është bërë në bazë të gjinisë, viteve dhe përkatësisë etnike. Mostra sipas kategorive kryesore sociodemografike është paraqitur në grafikun numër 1.

Grafiku 1: Struktura socio-demografike i të anketuarëve (%)



Kur bëhet fjalë për strukturën nacionale, siç edhe e përmendëm, kemi bërë “oversampling” me qëllimin e matjeve preçize të distancës etnike. Struktura e mostrës sipas përkatësisë etnike është paraqitur në grafikun 2.

Grafiku 2: Struktura etnike modeli- N⁵



Në analizë kemi përdorur mostër me peshë përfaqësuese kur bëhet fjalë për qëndrimet ndaj të drejtave të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare dhe vlersimit të këshillit të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare, ndërsa kur bëhet fjalë për distancën etnike përdorëm mostrën që u përforcua nga kategoritë etnike që kemi përmendur.

5 Në Mal të Zi, përqindja e qytetarëve që deklarohen si Kroat është 0.97%, kjo është arsyeja pse disa prej tyre janë proporcionale dhe të kampionuara. Pasi që vlefshmëria e sondazhit në nivelin Malazez varet nga përfaqësimi i kampionit, një numër kaq i vogël nuk lejon matjen e saktë të distancës etnike të cilët shfaqin anëtarët e këtij grupi ndaj grupeve të tjera. Për shkak të dhënave më sipër, është e mundur të matet vetëm distanca etnike e të gjithëve ndaj Kroatëve

Ushtrimi i të drejtave të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare

Me anë të hulumtimit arrijmë në përfundimin e një grupi të të drejtave të cilat minoritetet dhe bashkësitë e tjera minoritare duhet të ushtrojnë. Në dokumentat kryesore të rëndësishme të qeverisë, mbi të gjitha strategjitë politike të minoriteteve, përgjithësuam 10 të drejta kryesore të cilat ishin baza e hulumtimit. Në hulumtim, për secilën nga të drejtat, anketuesit u përgjigjën se në deri çfarë mase këto të drejta respektohen duke përdorur shkallën e vlersimit Likertovu me katër pika. Matja e rezultateve kryesore në nivelin e gjithë popullatës paraqitet në grafikun 3.


Grafiku 3: Të drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare respektohen kryesisht dhe plotësisht (%)



Të dhënat tregojnë ndryshime relativisht të vogla, kur bëhet fjalë për përqindjen e realizimit të të drejtave. Krahësimisht, janë në masën më të lartë, sipas vlersimit të qytetarëve, realizimi i të drejtave kur bëhet fjalë për përdorimin e përgjithshëm të gjuhës amëtare, ndërsa në masën më të vogël kur bëhet fjalë për të drejtën e punësimit të barabartë.

Për sa kohë, të dhënat krahasuese për përmbushjen e të drejtave i krahasojmë me analizat e referuara vitit 2018-të, atherë shohim ndryshimin gjatë grafikut 4. Edhe pse ndryshimet nuk janë veçanërisht të theksuara, të paktën mund të thuhet se vlersimi i shtetasve të Malit të Zi tregon se sa të drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare në një masë të vogël janë realizuar sesa ishte rasti i vitit 2018.

Grafiku 4: E drejta minoritare dhe bashkësive të tjera minoritare respektohen plotësisht dhe kryesisht (%) - krahasimi ndërmjet viteve 2018- 2019




Sidoqoftë, të dhënat që kemi paraqitur i përkasin vlersimit i të gjithë ankëtarëve. Domethënë, ato janë ndërtuar në bazë të një kampioni përfaqësues të të gjithë qytetareve të Malit të Zi. Duhet patur parasysh se kur bëhet fjalë për të drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera etnike, e rëndësishme është pyetja se në çfarë mënyre të drejtat minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare i vlersojnë vet anëtarët e grupeve etnike individuale. Këto të dhëna paraqiten në tabelen 1. Interesante është se Boshnjakët dhe Myslimanët vlersojnë në mënyrën më pozitive përmbushjen e të gjithë të drejtave, me tepër edhe në krahasim me malazezët. Vlerat për Serbët janë dukshëm më të ulëta sesa ato të matura tek malazezët, ndërsa kur bëhet fjalë për Romët, veçanërisht anëtarët e këtyre grupeve etnike vlerësuan negativisht të drejtën e përfshirjes në organizimet politike dhe të drejtën e luftimit kundër diskriminimit etnik.

Tabela 1: Te drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare plotësisht dhe kryesisht (%) -nga ana e anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike

	E drejta për të përdorur gjuhën e vet amëtare	E drejta e komunikimit në gjuhën e vet	E drejta në organizimet politike	E drejta për arsim në përputhje me specifikat e çdo pakice.	E drejta e lirisë së fjalës	E drejta e luftimit ndaj diskriminimit etnik	E drejta e barazisë në punësim	E drejta e trajtimit në mënyrë të barabartë nga organet qeveritare	E drejta e paraqitjes në media	E drejta e mbrojtjes së vlerave të tyre kulturore dhe specifikat
Malazez	58.1	52.4	57.9	54.5	54.7	55.1	46.3	49.9	52.3	49.6
Serb	40.6	38.1	40.4	40.8	37.5	38.0	31.4	33.8	38.3	37.8
Shqiptar	41.0	37.9	41.4	39.4	45.8	38.1	32.9	37.6	42.5	41.8
Boshnjak	78.1	66.9	62.5	71.8	65.3	61.5	50.5	57.1	65.4	68.5
Mysliman	81.5	72.0	73.3	72.1	77.7	69.6	63.8	75.6	79.8	77.0
Rom	53.4	50.5	17.1	50.8	63.5	17.1	39.5	49.5	55.0	17.1

Më në fund, të gjitha vlerat e tabelës nr 1 i mbledhëm në formën e llogaritjes së përqindjes mesatare në respekt të të GJITHA të drejtave për ÇDO grup etnik. Faktikisht, në këtë mënyrë, morëm vlerën e arritjes e të gjithë të drejtave nga ana e të gjithë grupeve etnike. Të dhënat paraqiten në grafikun nr 5 dhe ato tregojnë se ata që deklarohen si Serb dhe Shqiptarë mendojnë se në masën më të madhe të mundshme të drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare nuk janë realizuar. Me një ndryshim të vogël i bashkangjiten anëtarët e grupeve romë, interesante është, ashtu siç e përmendëm edhe më sipër që Boshnjakët dhe veçanërisht Myslimanët vlersojnë se të drejtat e minoriteteve janë realizuar në masën më të lartë sesa e vlersojnë Malazezët.


Grafiku 5: Përqindja e vlerës mesatare të respektimit i të gjitha të drejtave nga ana e anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike (%)



Besimi tek institucionet dhe vlersimi i punës së Keshillit të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare


Në shoqërinë demokratike, institucionet luajnë rol mjaft të rëndësishëm kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të minoritetetve dhe bashkësive të tjera minoritare. Efekti i institucioneve mund të matet në mënyra të ndryshme por sigurisht një nga masat e rëndësishme të efektivitetit të tyre është besimi që qytetarët kanë në këto institucione. Teorikisht, kjo është gjithashtu një nga masat e kapitalit shoqëror në shoqëri. Prandaj në hulumtim ndërfutëm matjen e besimit në institucione. Tregues besimi në nivel varincë totale paraqitet në grafikun 6.

Grafiku 6: Besimi ne institucione-(%) SUM besimi i madh dhe kryesisht



Në mënyrë tradicionale, shkalla më e lartë të besimit e masim në sistemin e arsimit, në sistemin shëndetësor, Kishën Ortodokse Serbe dhe policia. Shkallë më të ulët të besimit e masim kur bëhet fjalë për Kishën Ortodokse Malazeze, partitë politike, Parlamentin e Malit të Zi. Në grafikun 7 tregohen matjet e vlerave të besimit në institucione kur të dhënat krahasohen me kerkimin e fundit të CEDEM, nga viti 2018-të. Edhe pse ndryshimet nuk janë të mëdha, përgjithësisht, sot masim një shkallë disi të ulët besimi në institucione sesa nga rasti i fundit i vitit të kaluar.

Grafiku 7: Besimi ne institucione -Trend (%)




Nxjerrja në dritë qëllimet e hulumtimeve tona, besimi në institucione në nivelin total të popullatës vëhet më pak në dukje në krahasim me të dhënat e shkallës së besimit të cilat tregojnë anëtarët e grupeve të ndryshme etnike. Prandaj, analizuam me të drejtë besimin në institucione nga kjo pikëpamje, ndërsa të dhënat e matjeve dhe analizat i paraqesim në grafikun 8-të. Ndryshimet janë indikative, me qëllimin e shprehjes dhe kuptimin e tyre sintetik, në grafikun numër 8, tregohet vlera mesatare e besimit në institucionet të cilat janë të kategorizuara. Kategorizimi është bërë në atë menyrë, ku të gjithë institucionet i ndajmë në tre grupe: (1) institucionet politike (Parlamenti, Presidenti, Qeveria, policia, gjykata, ushtria) (2) institucionet shoqërore (shëndeti, arsimi, OJQ) dhe organizatat ndërkombëtare (Delegacioni BE, NATO dhe UN). Nga llogaritja për shkak të specifikave janë përjashtuar Kisha Ortodokse Serbe dhe Kisha Ortodokse Malazeze. Të dhënat tregojnë se minoritetet dhe bashkësitë e tjera minoritare kanë besim më të madh tek organizatat ndërkombëtare sesa në institucionet e Malit të Zi. Në përgjithësi, matjet e vlerave tregojnë se Boshnjakët dhe Myslimanët kanë shkallë të lartë besimi në të gjithë llojet e kategorive institucionale, kur krahasohet me grupet e tjera etnike, ndërsa nivel më të ulët kanë Romët. Serbët karakterizohen nga shkalla mjaft e ulët besimi, sidomos kur bëhet fjalë për organizatat ndërkombëtare, por edhe në institucionet politike në Mal të Zi.

Tabela 2: Besimi në institucione- Krahasimi ndërmjet anëtarëve të grupeve kryesore etnike

	Malazeze	Serb	Shqiptar	Boshnjak	Mysliman	Rom
Parlamenti	37.4	12.7	29.9	48.1	58.0	25.2
Presidenti	41.7	11.1	37.8	78.0	73.5	28.2
Qeveria	38.7	13.6	40.8	68.8	69.6	25.2
Policia	49.0	20.0	43.1	24.4	81.5	35.0
Gjykata	44.8	16.9	43.1	55.6	64.2	28.4
Arsimimi	59.4	40.4	23.9	64.8	79.9	35.5
Shëndeti	47.5	30.7	42.0	63.2	74.8	35.2
Partitë	28.9	11.0	15.3	40.8	48.0	25.5
Kisha Ortodokse Serbe	38.6	75.4	11.5	9.6	12.9	10.4
Kisha Ortodokse Malazeze	22.2	8.4	11.1	24.6	18.4	17.3
Ushtria	41.7	24.0	33.3	52.1	62.7	28.4
OJQ-të	44.6	32.2	32.0	49.2	48.0	41.4
Delegacioni i Bashkimikt European	47.6	15.3	48.6	63.0	75.4	44.4
NATO	37.3	7.1	62.8	71.5	73.0	51.5
Kombet e Bashkuara	44.6	15.3	48.2	61.7	71.5	51.5


Grafiku 8: Besimi ne institucione sipas kategorive (%)



Vlerësimi i punës së Ministrisë dhe Këshillit të minoriteteve si dhe bashkësive të tjera minoritare


Ministria për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve është adresa e parë insitucionale kur bëhet fjalë për të drejtat e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare. Prandaj gjatë hulumtimit anketuam vlerësimin e qytetarëve Malazezë, kur bëhet fjalë për vlerësimin e punës së kësaj ministrie. Rezultatet e matjeve paraqiten në grafikun 9. Të dhënat tregojnë se një numër i madh i të anketuarëve nuk është në gjëndje të vlersojnë punën e ministrisë, ndërsa nga ata që e vlerësuan, përqindja më e lartë (çdo i katërt i anketuar) shprehën se ministria punon kryesisht mire. Kumulativisht, më shumë se ¼ e të anketuarëve vlerësuan punën e ministrisë dobët ose shumë keq.

Grafiku 9: Si do ta vlerësonit punën totale të Ministrise për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve kur bëhet fjalë për mbrojtjen e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare?




Sidoqoftë, si dhe në treguesit e mëparshëm, edhe në këtë drejtim indikativ është treguesi rreth asaj sesi puna e ministrisë, kur bëhet fjalë për mbrojtjen e minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare, e vlersojnë anëtarët e grupeve të ndryshme etnike, veçanërisht minoritetet dhe bashkësitë e tjera minoritare, sesa nga të dhënat e shfaqura e cila vlen për varijansën totale. Prandaj, në Grafikun 10 paraqesim të dhëna analitike, më saktë përqindjen e anëtarëve të të gjitha grupeve kryesore etnike kur bëhet fjalë për vlerësimin e punës së ministrisë. Të dhënat tregojnë se Boshnjakët dhe Myslimanët vlersuan më mirë punën e ministrisë. Vlersimi është solid dhe kur bëhet fjalë për pjesën më të madhe të Malazëzëve, por nuk është e kënaqshme kur behet fjalë për vlersimin e Shqiptarëve. Më në fund, më shumë pakënaqësi kemi kur bëhet fjala për Serbët, dhe veçanërisht Romët. Domethëne, pjestarët e dy grupeve të fundit nacionale, veçanërisht janë të pakënaqur me punën e Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve.

Grafiku 10: Vlerësimi i punës së Ministrisë të të drejtave të njeriut dhe minoriteteve kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare (%)




Në segmentin e radhes të hulumtimit, anketuesit vlerësuan punën e Këshillit të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare. Metodiskisht, për çdo këshill, ata vlerësuan kontributin që japin këto këshilla për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare. Në grafikun 11 tregohen të dhënat e vlerësimit të kontributit të të gjithë këshillave. Të dhënat vlejné për të gjithë popullatën dhe jepen sipas hierarkisë së shpeshësisë së përgjigjeve pozitive, ndërsa përqindjet paraqesin shumën e përgjigjeve ku këshilli ka kontributun me të madh dhe domethënë. Në nivelin e varijsës totale më mirë është vlersuar Këshilli i Boshnjakëve në Mal të Zi, si dhe Këshilli Popullor i Myslimanëve dhe Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve.

Grafiku 11: Vlerësimi i Këshillit të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare -% kontributi i madh dhe domethënës



Vlerësimi i të gjithë këshillave po me të njëjtën metodologji e përfunduar në fund të vitit 2018-të, prandaj në grafikun 12 paraqesim të dhënat krahasuese në matjen vlerës së punës së këshillit për dy hulumtime. Të dhënat tregojnë në nivel të variancës totale, se puna e këshillave të të gjithë minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare është e vlersuar më mirë këtë vit, sesa në rastin e fundit të vitit 2018-të. Nga ana tjetër, Këshilli Kombëtar Serb, Qendra për ruajtjen dhe zhvillimin kulturor të minoriteteve dhe Fondi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të minoriteteve në Mal të Zi janë vlersuar pothuajse njësoj, siç edhe ishte rasti i fundit në dhjetor të vitit 2018.

Grafiku 12: Paraqitja e vlerave krahasuese të këshillit e shprehur në (%) kontributi i madh dhe domethënës për vitet 2018- 2019



Duke patur parasysh se çdo këshill është menduar për të përfaqësuar intersat e veçantë të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare, informacioni që kemi paraqitur është më pak i rëndësishëm nga vlersimi që kanë anëtarët e cdo minoriteti dhe bashkësive të tjera minoritare ndaj Këshillit të “tyre”. Prandaj në tabelën numër 3 paraqiten vlerësimet e të gjithë këshillave nga krahu i të gjithë anëtarëve të grupeve etnike. Të dhënat tregojnë se Myslimanët vlersuan më mirë këshillin e “tyre” e më pas Boshnjakët të “tyren” Shqiptarët vlersuan relativisht lartë këshillin e “tyre” ndërkohë që Serbët dhe Romët vlersuan ulët punën e këshillit të tyre. Ne gjithashtu vërejmë se Myslimanët përveçse vlerësimit të lartë të këshillit të tyre, vlerësuan dhe Këshillin Boshnjak, por edhe Qendrën për mbrojtjen dhe zhvillimin kulturor të minoriteteve. Si përfundim, indikative është që Boshnjakët në mënyrë solide vlersuan Këshillin Popullor i Myslimanëve.

Tabela 3: Vlerësimi i Këshillit të minoriteteve dhe bashkësive të tjera minoritare nga entiteti (%) -- % i madh dhe domethënës kontributi

	Malazez	Serb	Shqiptar	Boshnjak	Mysliman	Rom
Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Mal të Zi	31.8	24.9	40.3	25.7	42.2	17.3
Këshilli i Boshnjakëve në Mal të Zi	31.5	26.2	22.5	47.3	55.9	17.3
Këshilli Kombëtar Kroat në Mal të Zi	29.4	20.3	17.2	23.0	23.5	17.3
Këshilli Popullor i Myslimanëve në Mal të Zi	31.6	28.3	18.5	39.2	55.3	17.3
Këshilli i Romëve në Mal të Zi	28.2	16.2	16.0	19.8	30.2	25.2
Këshilli Kombëtar Serb	25.0	21.1	14.2	10.3	19.4	17.3
Qendra për ruajtjen dhe zhvillimin kulturor të minoriteteve	26.4	14.8	21.8	24.1	40.0	14.1
Fondi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave minoritare	26.8	12.4	22.8	26.4	46.6	14.1

Matja e distancës etnike

Pjesa më e rëndësishme e këtij hulumtimi ishte dhe matja e distancës etnike. Matjen e parë që CEDEM realizoi për distancën etnike e kreu në vitin 2007, paskësaj tjetër e realizoi në vitin 2013, e më pas për të realizuar edhe dy- një në 2018 dhe e fundit ajo çka po prezantojmë tani. E thënë ndryshe, kemi përmbledhjen e distancës etnike në formë trendi që nga periudha kur u shpall pavarësia e Malit të Zi e deri më sot. Prandaj, si fillim do paraqesim rezultatet e matjes së distancës etnike nga hulumtimet e fundit, pas kësaj do të shfaqim të dhënat kryesore që i përkasin trendit të distancës etnike. Përndryshe, metodikisht matim distancën etnike, tradicionalisht me shkallën e distancës shoqërore Bogardusovom e cila, përveç 7 ajtemave autentike/marrëdhënieve autentike përfshin edhe dy të tjera të cilat në praktikën e kërkimit rezultuan të vlefshme. Përsëri, metoda e shkallës Bogardusova është shakalla Gutmanovog, domethënë tip kumulativ. Ajo shqyrton (jo)/dëshirën e vendosjes së marrëdhënieve të caktuara me anëtarët e grupeve të caktuara shoqërore, në situatën tonë konkrete grupet etnike. Marrëdhëniet jepen sipas hierarkisë, në mënyrë që çdo marrëdhënie tjetër të nënkuptojë shkallë më të lartë afërsie, si pasojë për çdo marrëdhënie të radhës pritet shkallë më e lartë distance.

Ajtemat/ marrëdhëniet që kemi përfshirë në hulumtim janë:

1. Që gjithmonë të jetojë në shtetin tim
2. Që të jetojë në fqinjësinë time (në të njëjtin pallat ose rrugë)
3. Që të kem bashkëpunor në punë
4. Që të jetë eprori im në punë
5. Që të jetë edukator i fëmijëve të mi
6. Që të shoqërohem me të dhe ta vizitoj
7. Që të ketë vend udhëheqës në shtetin tim
8. Që të jemi në faqefisni të largët përmes martesës me kushurinj
9. Që të jemi në faqefisni të afërt përmes martesës së vet ose martesës së fëmijëve


Tabela 4: Distanca nderetnike sipas ajtemeve/marëdhënieve

		Të jetojë në të njëjtin	Fqinj	Bashkëpunëtor në punë	Eproti në punë	Edukon fëmijët	Shoqërim dhe dedikim	Pozicioni drejtues në	Farefisnia e elargët	Farefisnia e afërt
Distanca ndaj Malazezëve	Serb	3.3%	2.8%	3.3%	4.7%	6.1%	3.8%	12.2%	6.6%	6.6%
	Shqiptar	2.2%	2.2%	5.9%	8.6%	12.4%	10.6%	10.8%	27.0%	45.4%
	Boshnjak	1.6%	0%	3.2%	11.3%	4.8%	3.2%	17.7%	51.6%	71.0%
	Mysliman	1.3%	1.3%	2.7%	5.3%	8.0%	2.7%	12.0%	50.7%	65.3%
Distanca ndaj Serbëve	Malazez	1.9%	1.3%	2.2%	3.8%	2.2%	1.0%	7.4%	5.4%	6.4%
	Shqiptar	14.6%	21.1%	21.1%	25.9%	33.5%	32.3%	34.1%	74.1%	91.9%
	Boshnjak	6.5%	8.1%	6.5%	29.0%	11.3%	11.3%	30.6%	62.9%	87.1%
	Mysliman	6.7%	8.0%	6.7%	14.7%	22.7%	5.3%	41.3%	80.0%	85.3%
Distanca ndaj Boshnjakëve	Malazez	8.7%	10.7%	10.1%	17.6%	17.3%	14.2%	29.0%	48.4%	66.3%
	Serb	23.1%	27.4%	27.8%	41.5%	41.0%	35.5%	61.1%	81.0%	91.0%
	Shqiptar	10.9%	10.9%	14.1%	18.5%	26.6%	26.1%	33.7%	55.1%	70.8%
	Mysliman	1.3%	1.3%	2.7%	5.3%	4.0%	1.3%	8.0%	6.7%	10.7%
Distanca ndaj Myslimanëve	Malazez	7.2%	10.1%	9.4%	16.9%	17.3%	13.6%	27.4%	49.2%	70.0%
	Serb	20.8%	25.5%	25.5%	38.7%	37.3%	31.6%	56.4%	81.5%	92.4%
	Shqiptar	7.0%	7.6%	9.7%	18.9%	21.1%	20.6%	24.9%	48.1%	59.5%
	Boshnjak	1.6%	1.6%	1.6%	3.2%	1.6%	1.6%	6.5%	6.5%	6.5%
Distanca ndaj Shqiptarëve	Malazez	21.7%	29.5%	26.9%	35.7%	39.0%	35.6%	46.8%	62.3%	80.5%
	Serb	49.1%	60.6%	58.7%	76.1%	76.5%	73.2%	84.0%	90.6%	95.8%
	Boshnjak	16.1%	29.0%	33.9%	48.4%	43.5%	43.5%	46.8%	64.5%	80.6%
	Mysliman	10.7%	25.3%	28.0%	41.3%	53.3%	38.7%	65.3%	76.0%	82.7%
Distanca ndaj Kroatëve	Malazez	16.5%	20.5%	20.5%	29.2%	30.5%	25.9%	38.3%	42.9%	55.5%
	Serb	42.9%	50.0%	51.4%	62.3%	62.7%	59.4%	75.9%	75.5%	84.9%
	Shqiptar	8.7%	10.3%	14.1%	23.6%	28.0%	27.3%	41.8%	61.9%	78.5%
	Boshnjak	8.1%	25.8%	27.4%	41.9%	43.5%	35.5%	41.9%	66.1%	88.7%
	Mysliman	25.3%	33.3%	33.3%	41.3%	58.7%	46.7%	73.3%	81.3%	90.7%
Distanca ndaj Romëve	Malazez	20.0%	39.0%	37.1%	54.5%	59.4%	53.9%	60.0%	80.0%	88.7%
	Serb	35.8%	58.8%	57.8%	76.3%	76.3%	74.9%	76.3%	90.5%	94.8%
	Shqiptar	35.3%	59.5%	64.2%	78.4%	81.1%	78.5%	83.2%	94.2%	94.2%
	Boshnjak	11.3%	24.2%	41.9%	58.1%	62.9%	54.8%	54.8%	85.5%	95.2%
	Mysliman	11.0%	38.4%	37.0%	54.8%	74.0%	57.5%	80.8%	91.8%	95.9%

Prandaj, për secilën nga marëdhëniet e dhëna anketuesit treguan nëse e/jo e dëshirueshme të realizosh marëdhëniet e përshkruara me anëtarët e grupeve të tjera etnike. Me qëllim tregimin e qartë të distancës, ne kemi formuar rezultatet që kanë një interval nga 0 (pa distancë) deri në 1 (distanca maksimale). Në këtë mënyrë, thjesht ndjekim shkallën e distancimit ndaj gjithë grupeve etnike, nga krahu i gjithë grupeve etnike, domethënë, në këtë mënyrë matet me saktësi dhe kumulativisht ndëretniciteti, si dhe distancën totale.

Me parë, në tabelen 4, tregojmë shkallën e distancës sipas të gjitha ajtemeve/marëdhënieve kundrejt gjithë grupeve etnike. Vlerat e matjeve mund të krahasohen në mënyrë individuale, në mënyrë sesi të përmbledhim analizat, grafiku do të paraqesë distancën e anëtarëve përkatës të grupeve etnike ndaj grupeve të tjera. Së pari, në grafikun 13, tregojmë shkallën e distancimit të malazezëve në krahasim me të gjitha grupet e tjera. Të dhënat tregojnë se malazezët distancohen në masën më të vogël në lidhje me Serbët, e thënë më saktë, Malazezët nuk tregojnë pothuajse fare distancë ndaj Serbëve. Nëse shikohet tabela e distancës totale ndëretnike, mund të shihet se ajtemi më i ndjeshëm është “që të ketë vendudhëheqës në shtetin tim” që do të thotë se në pjesën më të madhe edhe kjo distanca minimale që shfaqin Malazezët ndaj Serbëve në të vërtetë, nuk është etnike por politike. Shkallën më të lartë të distancimit Malazezët e shfaqin ndaj Romëve, dukshëm ulët ndaj Shqiptarëve, akoma më ulët ndaj Kroatëve. Anëtarët e këtyre grupeve etnike shfaqin nivel të ulët distance (përveç se kur bëhet fjalë ndaj Serbëve) në krahasim me Boshnjakët, Myslimanët.


Grafiku 13: Distanca që tregojnë Malazezet kundrejt gjithë anëtarëve të tjerë



Në grafikun 14 jepet përmbledhja e distancës së Serbëve në marredhënie me anëtarët e grupeve të tjera etnike. Njësoj siç edhe matëm, nuk ka pothuajse fare distancë që tregojnë malazezët ndaj Serbëve, vlen e dhe e kundërta, etj. Serbët, nuk kanë pothuajse fare distancë ndaj malazezëve. Përsëri, siç edhe në rastin e mësipërm, ajtemi më delikat është „Që të ketë vendudhëheqës në vendin tim. E thënë ndryshe, dhe distanca të cilën Serbët tregojnë ndaj malazezëve, në maën më të latë është politike, dhe jo etnike. Sidoqoftë, Serbët tregojnë një nivel relativisht më të lartë krahasuar me anëtarët e grupeve të tjera etnike, në krahasim me malazezët. Shkallë më të lartë distancimi, ata të cilët deklarohen


Serb e shfaqin ndaj Shqipëtarëve, e më pas ndaj Romëve. Megjithatë, vlerë të lartë matim edhe kur bëhet fjalë për distancën në lidhje me Kroatët, ndërsa diçka e ulët, edhe pse gjithmonë e krahasimisht e lartë, kur flasim për distancën etnike në lidhje me Boshnjakët dhe Myslimanët.

Grafiku 14: Distanca që tregojnë Serbët kundrejt gjithë anëtarëve të grupeve të tjera




Në grafikun 15, shfaqim evidenca që tregojnë shkallën e distancimit të treguar nga Boshnjakët në lidhje me anëtarët e të gjitha grupeve të tjera etnike. Së pari, të dhënat tregojnë se pothuajse nuk ka distancë midis Boshnjakëve dhe Myslimanëve, që është e kuptueshme duke pasur parasysh se grupi etnik këtu është një dhe i njëjti. Boshnjakët shkallën më të madhe të distancimit e shfaqin në lidhje me Romët, pastaj me Shqiptarët dhe Kroatët. Distanca te cilët tregojnë Boshnjakët në lidhje me Serbët është dukshëm ulët, ndërsa akoma më e ulët distanca është në lidhje me Malazezët.

Grafiku 15: Distanca që tregojnë Boshnjakët kundrejt gjithë anëtarëve të grupeve të tjera



Rezultatet e matjes së distancës të cilët tregojnë Myslimanët ndaj anëtarëve e të gjitha grupeve të tjera pothuajse është identike, siç është edhe rasti për distancën që tregojnë Boshnjakët. Përsëri, arsyeja është që këtu bëhet fjalë për grupe të njëjta etnike (grafiku 16). Domethënë, shkalla më e lartë e distancës është ndaj Romëve, paskësaj vinë Kroatët, Shqiptarët, ndërkohë që distanca është dukshëm ulët ndaj Serbëve, ndërsa më e ulët ndaj Malazezëve. Ashtu, si pothuajse asnjë Boshnjak nuk tregon distancë ndaj Malazezëve, vlen edhe anasjelltas, pothuajse nuk kemi fare distancë të Myslimanëve ndaj Boshnjakëve.

Grafiku 16: Distanca që tregojnë Myslimanët kundrejt gjithë anëtarëve të grupeve të tjera




Si e dhënë e cila tregon mënyrën sesi Boshnjakët distancohen në marëdhënie me grupet e tjera etnike është pothuajse e njëjtë me referimin e distancës që kanë Myslimanët, paraqitet në grafikun 16.1. I vetmi ndryshim, në këtë drejtim të cilën identifikua, është distanca në lidhje me Kroatët.

Grafiku 16.1: Distanca që tregojnë Myslimanët në krahasim me ato që tregojnë Boshnjakët ndaj anëtarëve të grupeve të tjera




Shqiptarët, shkallën më të lartë të distancimit e tregojnë ndaj Romëve (grafiku 17). Distanca është dukshëm ulët në krahasim me anëtarët e grupeve të tjera. Krahasimisht, pas distancës ndaj Romëve, Shqiptarët tregojnë shkallë më të lartë distance ndaj Serbëve, ndaj Boshnjakëve dhe Myslimanëve, ndërsa shkallën më të ulët të distancimit anëtarët e këtyre grupeve etnike e tregojnë ndaj Malazezëve.

Grafiku 17: Distanca që tregojnë Shqiptarët kundrejt gjithë anëtarëve të grupeve të tjera




Me në fund, për herë të parë në hulumtim patëm numër të mjaftueshëm Romë, çka na mundësojnë të matim shkallën e distancimit të anëtarëve të këtyre grupeve etnike ndaj të gjithë grupeve të tjera etnike (grafiku 18). Të dhënat janë indikative dhe ato tregojnë se Romët në shkallën më të lartë distancohen ndaj Kroatëve dhe Shqipëtarëve. Pas kësaj, vjen distanca ndaj Serbëve, ndërkohë që distanca ndaj Malazezëve dhe Boshnjakëve është shumë e ulët, ndërsa ndaj Myslimanëve nuk ka pothuajse fare distancë.

Grafiku 18: Distanca që tregojnë Romët kundrejt gjithë anëtarëve të grupeve tjera




Më në fund, në baze të gjithë vlerave, mund të matim distancën totale e cila tregohet ndaj anëtarëve të gjithë grupeve etnike (grafiku 19). Të dhënat tregojnë që shkalla më e lartë e distancës totale etnike është ndaj Romëve, pasandaj ndaj Kroatëve, Shqiptarëve, si dhe ndaj Boshnjakëve dhe Myslimanëve, e në fund ndaj Serbëve dhe Malazezëve.

Grafikon 19: Distanca totale kundrejt gjithë grupeve etnike



Kur krahasojmë shkallën e distancës së anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike, të vitit 2019, shkallë më të lartë distance tregojnë Serbët, pasandaj Boshnjakët dhe Myslimanët si dhe Shqiptarët, ndërsa shkallën më të lartë distancimi në krahasim me të tjerët e matim tek Malazezët (grafiku 20).

Grafiku 20: Distanca totale nga ana e të gjithë anëtarëve të grupeve etnike⁶




Për më tepër, formuam të dhëna që tregojnë ndryshime të distancës ndëretnike në katër vale hulumtimi (grafiku 21). Të dhënat në përgjithësi tregojnë se shkalla e distancimit në vitin 2007 ishte shumë e lartë, dhe me kalimin e kohës po zvogëlohej. Sidoqoftë mund të vërejmë se me përjashtim të vitit 2018-të shkalla e distancës që Serbët shfaqin në krahasim me gjithë grupet e tjera është


⁶ Boshnjakët dhe Myslimanët në këtë grafikë shfaqen të ndarë, sepse kanë pothuajse nivel të njëjtë distance, domethene nuk ka dallime domethënëse midis tyre.

më e larta. Më në fund, në vitin 2018-të, shkallë më të lartë distancimi treguan Shqiptarët, në mënyrë që shkalla e distancimit që shfaqin anëtarët e gjithë ketyre grupeve etnike ra në mënyrë të konsiderueshme në hulumtimin e fundit.

Grafiku 21: Distanca totale ndëretnike nga ana e të gjithë anëtarëve të grupeve etnike -Trend⁷



Grafiku 22: Distanca totale etnike - trend⁸




Si përfundim, ne ofrojmë të dhëna për trendin e distancës ndëretnike në nivelin e të gjithë mostrës për të gjitha periudhat sipas gjithë grupeve (grafiku 22). Të dhënat tregojnë që distanca në vitin 2007 ishte në nivelin më të lartë, pastaj pësoi rënie në vitin 2013, për tu pasuar me rritje në vitin 2018; pastaj, më në fund, distanca që kemi matur me sondazhin e fundit (viti 2019), ishte pak më

⁷ Boshnjakët dhe Myslimanët në këtë grafikë shfaqen të ndarë, sepse kanë pothuajse nivel të njëjtë distance, domethene nuk ka dallime domethënëse midis tyre.

⁸ Boshnjakët dhe Myslimanët në këtë grafikë shfaqen të ndarë, sepse kanë pothuajse nivel të njëjtë distance, domethene nuk ka dallime domethënëse midis tyre.

e ulët se vitin e kaluar. Keto të dhëna si përfundim i paraqesim si komulative sipas viteve në grafikun 23.

Grafiku 23: Distanca totale-Trend





Maškaretnikane relacie thaj etnikani distanca ani Crna Gora



Crna Gora
Ministarstvo za ljudska
i manjinska prava

Juno 2019.



© Centar za demokratiju i ljudska prava (CEDEM)

Editoro:

Centar za demokratiju i ljudska prava – CEDEM
(www.cedem.me)

Bašo Editoro:

Milena Bešić

Autoro:

prof. dr Miloš Bešić

Nakhavno:

Elvis Beriša

Dizajno, grafika thaj printipe:

Marko Mihailović, M studio doo, Podgorica

Gaćipe:

100 kotora



Crna Gora
Ministarstvo za ljudska
i manjinska prava

Gindipe mothavdine ande kaja publikacia numaj si holjardipe CEDEM-esko thaj naj refleksia pe gindipe e Ministeriumesko manušengere thaj minoritetenge hakajengo.

SAINĆARIPE

GRAFIKONENGO DIĆHIPE.....	58
TABELENGO DIĆHIPE.....	59
ANGLUNO LAV	61
Resipe hakajengo minoritetenge selengo thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipa	65
Paćajpe ane institucije thaj bućikeripasko moll e minoritetnikane Konsilenge thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipa	68
Bućikeripaski moll Ministeriumesko thaj minoritetnikane konsilenge thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipe.....	71
Napi etnikane distancako.....	75

GRAFIKONENGO DIČHIPE

Grafikono 1: Sociodemografikani struktura e phucljengo (%).....	61
Grafikono 2: Etnikani struktura losardengo – N	62
Grafikono 3: Hakaja e minoritetenge selengo thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipa pačoven sa thaj uglavnom (%)	63
Grafikono 4: Hakaja e minoritetenge selengo thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipa pačoven sa thaj uglavnom (%)	64
- komparacia 2018. i 2019. berš.....	64
Grafikono 5: Maškarutno procentno mollipen e pačoveripasko SA hakajengo katar e averčhande etnikane grupacije (%)	65
Grafikono 6: Pačajpe ane institucije – (%) sum baro thaj uglavnom pačajpe.....	66
Grafikono 7: Pačajpe ane institucije – Trendo (%).....	67
Grafikono 8: Pačajpe ane institucije pe kategorije (%).....	68
Grafikono 9: Bučikeripasko moll e Ministeriumo manušenge thaj minoritetenge hakaja kana si o lav e arakhadimasko e minrotetenge selengo thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipa.....	69
Grafikono 10: Bučikeripasko moll e Ministeriumo manušengere thaj minoritetenge hakaja kana si o lav e arakhadimasko e minrotetenge selengo thaj aver minoritetnikane naciona- lno khedipa - SUM % but lače thaj lače.....	70
Grafikono 11: Dindo moll e konsilengo minrotetenge selengo thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipa - % baro thaj baro džanlipasko kontributo	70
Grafikono 12: Komparativnikano dikhlipe ko bučikeripasko moll e konsilengo ane % baro thaj baro džanlipasko kontributo e 2018. i 2019. beršenge	71
Tabela 3: Dindo moll e konsilengo minoritetenge selengo thaj aver minoritetnikane nacionalno khedipa palo etniciteto - baro thaj baro džanlipasko kontributo (%)	72
Grafikono 13: Distanca savi mothon e Crnogorcora pe sarsave peravne aver grupacijenge.....	75
Grafikono 14: Distanca savi mothon e Srbijancora pe sarsave peravne aver grupacijenge.....	76
Grafikono 15: Distanca savi mothoven e Bošnjakora pe sarsave peravne aver grupacijenge	76
Grafikono 16: Distanca savi mothoven e Muslimanora pe sarsave peravne aver grupacijenge..	77
Grafikono 16.1: Distanca savi mothoven e Muslimanora mamuj okolače savi e Bošnjakora mothoven pe sarsave peravne aver grupacijenge.....	77
